



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.legjislacionishqiptar.gov.al

Nr.135

21 dhjetor

2006

P Ë R M B A J T J A

Ligj nr.9645
datë 27.11.2006

Për Buxhetin e Shtetit të vitit
2007.....

Faqe

5257

LIGJ
Nr.9645, datë 27.11.2006

PËR BUXHETIN E SHTETIT TË VITIT 2007

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 158 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
BUXHETI I SHTETIT

Neni 1

Buxheti i Shtetit për vitin 2007 është:

Të ardhurat	253 795milionë lekë
Shpenzimet	300 643milionë lekë
Deficiti	46 848milionë lekë

Buxheti i Shtetit përbëhet nga fondi i konsoliduar, buxheti i sigurimeve shoqërore dhe buxheti i sigurimeve shëndetësore.

Neni 2

A. Fondi i konsoliduar për vitin 2007 është:

Të ardhurat	210 995milionë lekë
Shpenzimet	257 843 milionë lekë
Deficiti	46 848 milionë lekë

Fondi i konsoliduar përbëhet:

A.1. Buxheti Qendror:

Të ardhurat	197 781	milionë lekë
Shpenzimet	244 629	milionë lekë

A.2. Buxheti i pushtetit vendor:

Të ardhurat	25 839milionë lekë
-------------	--------------------

Nga të cilat:

Granti i pakushtëzuar nga Buxheti Qendror	12 625	milionë lekë
Shpenzimet	25 839	milionë lekë

Neni 3

B. Buxheti i sigurimeve shoqërore për vitin 2007 është:

B.1. Skema e sigurimit të detyrueshëm shoqëror

Të ardhurat, gjithsej	56 142	milionë lekë
- Nga kontributet	38 080	milionë lekë
- Transferimet nga Buxheti i Shtetit	18 062	milionë lekë
Shpenzimet	56 142	milionë lekë

Paga minimale, për efekt të pagesës së kontributit të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, përcaktohet nga Këshilli i Ministrave dhe ndryshon sa herë që rriten pagat dhe pensionet. Këshilli i Ministrave ka të drejtë të përcaktojë një kontribut të veçantë minimal për personat e vetëpunësuar në bujqësi dhe kategori specifike të personave të vetëpunësuar. Për vitin 2007 teprica e të ardhurave, sipas degëve të sigurimit shoqëror, përdoret për mbulimin e deficitit të degës së pensioneve.

B.2. Skema e sigurimit suplementar

Të ardhurat, gjithsej	3 571	milionë lekë
- Nga kontributet	183	milionë lekë
- Transferimet nga Buxheti i Shtetit	3 388	milionë lekë
Shpenzimet	3 571	milionë lekë

Neni 4

C. Buxheti i sigurimeve shëndetësore për vitin 2007 është:

Të ardhurat, gjithsej	10 082	milionë lekë
- Nga kontributet dhe të tjera	4 537	milionë lekë
- Transferimet nga Buxheti i Shtetit	5 545	milionë lekë
Shpenzimet	10 082	milionë lekë

Shpenzimet për shërbimin e kujdesit shëndetësor parësor miratohen, ekzekutohen dhe raportohen nga sistemi i thesarit për të gjithë zërat dhe nënzërat e klasifikimit buxhetor që zbatohen për institucionet buxhetore.

Neni 5

Përdorimi dhe investimi i fondit rezervë të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore bëhet sipas dispozitave ligjore në fuqi.

KREU II

BURIMET PËR MBËSHTETJEN E SHPENZIMEVE TË FONDIT TË KONSOLIDUAR

Neni 6

Të ardhurat e fondit të konsoliduar, sipas grupeve kryesore, janë:

Grantet	6 386	milionë lekë
Të ardhurat tatimore	173 975	milionë lekë
Të ardhurat jotatimore	17 420	milionë lekë
Të ardhurat e buxhetit vendor	13 214	milionë lekë

Neni 7

Kufiri i financimit të deficitit të Buxhetit të Shtetit nga burime të brendshme është 26 000 milionë lekë, nga i cili 1 000 milionë lekë financohen nga të ardhurat e privatizimit. Në rast mosrealizimi të të ardhurave të buxhetit dhe të ardhurave nga privatizimi, huamarrja për financimin e deficitit të brendshëm prej 25 000 milionë lekësh nuk ndryshon. Këshilli i Ministrave merr masa për kompensimin e diferencave nga burime suplementare ose nga shkurtimi i shpenzimeve. Kufiri neto i financimit nga burimet e huaja është 20 848 milionë lekë. Ky kufi mund të ndryshojë gjatë vitit brenda limiteve të përcaktuara në nenin 16 të këtij ligji.

KREU III

SHPENZIMET E FONDIT TË KONSOLIDUAR

Neni 8

Shpenzimet e fondit të konsoliduar, sipas grupeve kryesore, janë:

Shpenzimet korrente	182 325	milione lekë
Shpenzimet kapitale	69 772	milione lekë
Rezerva e Këshillit të Ministrave	1 700	milione lekë
Kontingjenca	4 046	milione lekë

Kufiri i shpenzimeve për çdo ministri dhe institucion është sipas tabelës 1, që i bashkëlidhet këtij ligji. Për institucionet e pavaruara nga Këshilli i Ministrave kufiri i shpenzimeve, numri i punonjësve dhe fondi i pagave është sipas tabelës 1/1, që i bashkëlidhet këtij ligji.

Neni 9

Fondet e pakushtëzuara janë kufi maksimal shpenzimi. Fondet e kushtëzuara përfshijnë shpenzimet për investime me burim financimet e huaja dhe shpenzimet nga të ardhurat që, me ligj ose me akte të tjera nënligjore, u përkasin ministrave dhe institucioneve të tjera buxhetore. Fondet e kushtëzuara, me burim të brendshëm, përdoren brenda vitit buxhetor.

Këshilli i Ministrave vendos norma dhe standarde financiare për shpenzimet operative, të cilat janë të detyrueshme për t'u zbatuar nga të gjitha institucionet buxhetore, në varësi ose jo të Këshillit të Ministrave, si dhe për organet e pushtetit vendor.

Neni 10

Numri maksimal i punonjësve buxhetorë më 1 janar 2007, sipas të cilit është përgatitur Buxheti i Shtetit i vitit 2007, është 110 000 punonjës. Ngarkohet Këshilli i Ministrave të përcaktojë numrin e punonjësve buxhetorë për çdo ministri dhe institucion qendror, me përjashtim të numrit të punonjësve të institucioneve të pavarura, që përcaktohen në tabelën 1/1, që i bashkëlidhet këtij ligji.

Neni 11

Shpenzimet kapitale nga burimet e brendshme dhe nga burimet e huaja, sipas programeve për çdo ministri dhe institucion qendror, paraqiten në tabelën 2, që i bashkëlidhet këtij ligji. Fondi i kontingjencës për investime prej 3 000 milionë lekësh, i detajuar në tabelën 2 të këtij ligji, përdoret në masën 20 për qind në përputhje me realizimin e të ardhurave të buxhetit në tremujorin e parë të vitit 2007 dhe 80 për qind në tremujorin e dytë të këtij viti.

Neni 12

Fondi i kontingjencës prej 4 046 milionë lekësh përdoret për rritjen e pagave dhe pensioneve, me miratim të Këshillit të Ministrave, në 6-mujorin e dytë të vitit 2007, në përputhje me realizimin e të ardhurave. Fondi rezervë i Këshillit të Ministrave prej 1 700 milionë lekësh përdoret për raste të paparashikuara të institucioneve buxhetore.

Neni 13

Paga e Presidentit, nga data 1 janar 2007, është 238 854 lekë në muaj. Kjo pagë rritet gjatë vitit, në përputhje me nenin 12 të këtij ligji dhe me politikat specifike për rritjen e pagave në sektorin buxhetor.

Neni 14

Fondet buxhetore për pushtetin gjyqësor paraqiten sipas tabelës 3, që i bashkëlidhet këtij ligji. Buxheti i pushtetit gjyqësor administrohet nga Zyra e Administrimit të Buxhetit Gjyqësor, në mbështetje të ligjit nr.8363, datë 1.7.1998 "Për krijimin e Zyrës së Administrimit të Buxhetit

Gjyqësor”. Bordi i kësaj Zyre mund të rishpërndajë deri në 10 për qind të totalit të fondeve për çdo nivel të pushtetit gjyqësor, si dhe të miratojë çdo transferim ndërmjet gjykatave të të njëjtit nivel, duke respektuar raportet ndërmjet shpenzimeve korrente dhe atyre kapitale, të paraqitura në tabelën 3, që i bashkëlidhet këtij ligji.

Neni 15

Transfertat e pakushtëzuara, që Buxheti Qendror ia transferon pushtetit vendor, përfshijnë fondet për përballimin e veprimtarive dhe të funksioneve, që përcaktohen në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Transfertat e pakushtëzuara shpërndahen ndërmjet organeve të pushtetit vendor, sipas formulës së paraqitur në aneksin 1, që i bashkëlidhet këtij ligji. Fondi i kompensimit, nga totali i transfertës së pakushtëzuar, përdoret nga Ministria e Financave në bashkëpunim me Ministrinë e Brendshme, në përputhje me kriteret e përcaktuara në aneksin 2, që i bashkëlidhet këtij ligji. Fondet për grantet konkurruese shpërndahen sipas aneksit 3, që i bashkëlidhet këtij ligji. Shuma e transfertës së pakushtëzuar për çdo organ të pushtetit vendor është paraqitur në tabelën 4, që i bashkëlidhet këtij ligji.

Fondet që, sipas këtij neni, u vihen në dispozicion organeve të pushtetit vendor, fondet e tjera që, me akte të tjera ligjore dhe nënligjore, u kalojnë organeve të pushtetit vendor dhe vendimet e këshillave të organeve të pushtetit vendor, që kanë lidhje me përdorimin e fondeve buxhetore, bëhen publike.

Neni 16

Kufiri i shpenzimeve, sipas tabelave 1, 1/1 dhe 2, që i bashkëlidhen këtij ligji, mund të rishpërndahet gjatë vitit ndërmjet ministrive/programeve nga Këshilli i Ministrave deri në masën 10 për qind të shumës totale të ministrisë/programit, të paraqitur në këto tabela. Bëjnë përjashtim nga ky kufi fondet e shpërndara nga grantet konkurruese.

Neni 17

Kufiri për rritjen vjetore të totalit ekzistues të borxhit të shtetit dhe atij të garantuar të shtetit, në dobi të palëve të treta përfituese, për vitin 2007 është 67 765 milionë lekë, i detajuar si më poshtë:

1. Kufiri për rritjen vjetore të totalit ekzistues të borxhit të shtetit, si rezultat i zbatimit të buxhetit të vitit 2007, është 52 631 milionë lekë, nga i cili:

- për kreditë e jashtme të drejtpërdrejta të Këshillit të Ministrave është 27 631 milionë lekë;
- për financimin e brendshëm të deficitit buxhetor është 25 000 milionë lekë.

2. Kufiri për rritjen vjetore të garancive të shtetit në dobi të palëve të treta përfituese është 4 180 milionë lekë.

3. Kufiri për rritjen vjetore të stokut të borxhit, si rezultat i riskedulimit të borxheve të vjetra të jashtme të papaguara, është 5 154 milionë lekë.

4. Kufiri për rritjen vjetore të stokut të borxhit, si rezultat i mbulimit të diferencave nga rivlerësimi i valutave, është 5 800 milionë lekë, i cili emetohet në përputhje me shumat e rezultuara pas certifikimit të bilancit të Bankës së Shqipërisë.

Neni 18

Ngarkohet Ministria e Financave të nxjerrë udhëzime për zbatimin e këtij ligji.

Neni 19

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 janar 2007.

Shpallur me dekretin nr.5158, datë 15.12.2006 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

ANEKS 1
FORMULA E TRANSFERTËS SË PAKUSHTËZUAR - KRITERET DHE KOEFICIENTET

Kriteri	Koeficient i	Vlera (në mijë lekë)	Arsyeja themelore
---------	-----------------	----------------------------	-------------------

Kriteri	Koeficient i	Vlera (në mijë lekë)	Arsyeja themelore
I. Transferta e Pakushtëzuar Gjithsej (10.725 miliard lekë) [TPGJ] Transferta e pakushtëzuar për një bashki ose komunë është e barabartë me shumën përkatëse të pjesës “a” që rezulton nga aplikimi i formulës së veçantë mbi shumën “A” (Shuma A = 9 miliardë lekë) plus shumën “b” që rezulton nga aplikimi i formulës së veçantë mbi totalin “B” të transfertës së pakushtëzuar (Shuma B = 1,725 miliardë lekë). Qarqet përfitojnë vetëm nga shuma “A” e transfertës sipas formulës përkatëse.			
A. Alokimi i pjesës A të Transfertës së Pakushtëzuar – (Shuma A = 9 miliardë lekë) [TPA]			
Pjesa e Qarqeve [Q]	9%	810,000	Ky raport u alokon Qarqeve fonde për shpenzimet e tyre administrative, për mirëmbajtje dhe investime të rrugëve rurale dhe për shpenzime të tjera operative.
Pjesa për Bashkitë/Komunat [B/K] 1. Shpërndarja e pjesës së Bashkisë/Komunës [B/K]	91%	8,190,000	Për të siguruar financimin e funksioneve kryesore të ushtruara nga niveli i parë i QV.
Grant i përgjithshëm [GP] = [GP] * 1.00	100%	8,190,000	Pjesa e plote për B/K alokohet në hapin e parë në grantin e përgjithshëm. Nuk alokohen fonde të veçanta për kompensim; fondi i kompensimit krijohet nëpërmjet kompensimit të tranzicionit (shih më poshtë)
2. Shpërndarja e Grantit të Përgjithshëm për Bashkitë/Komunat			
Popullsia [P-B/K] = [GP-B/K] * 0.70	70.0%	5,733,000	Ky është kriteri dominant, pasi popullsia është një indikator i lidhur ngushtë me shpenzimet dhe nevojat për shërbime. Alokimi i [P-B/K/] ndahet proporcionalisht me popullsinë relative të çdo Bashkie/Komune kundrejt popullsisë totale. Për vitin 2007 të dhënat e popullsisë janë marrë nga regjistrimet e bëra për zgjedhjet e 3 Korrikut 2005.
Sipërfaqja e komunave [S-K] = [GP-B/K] * 0.15	15%	1,228,500	Ky element është i aplikueshëm vetëm për komunat. Komuna me sipërfaqe më të madhe nënkupton (për të gjitha kushtet e tjera të barabarta) se ka rrugë më të gjata dhe sfida të tjera infrastrukturore që kushtojnë. Të dhënat e sipërfaqeve të komunave janë marrë nga Instituti i Gjeografisë. Alokimi i [S-K] ndahet proporcionalisht me sipërfaqen relative të çdo komune kundrejt sipërfaqes totale. Për 178 komuna malore sipërfaqja është llogaritur si totali i sipërfaqes bazë shtuar me pesë herë.
Shërbimet Urbane [SU-B] = [GP-B/K] * 0.15	15%	1,228,500	Ky koeficient për simetri me komunat është 15 % e totalit të fondit dhe ndahet proporcionalisht me popullsinë relative të çdo bashkie kundrejt popullsisë totale të bashkive. Për Bashkitë e vlerësuara si bashki në nevojë koeficienti i shërbimeve urbane është llogaritur duke shtuar me 2 herë numrin faktik të popullsisë. Për bashki malore, koeficienti i shërbimeve urbane është llogaritur duke shtuar me 2 herë numrin faktik të popullsisë.

Kriteri	Koeficient i	Vlera (në mijë lekë)	Arsyeja themelore
			Për bashkitë malore e njëkohësisht në nevojë koeficienti i shërbimeve urbane është llogaritur duke shtuar 4 herë numrin faktik të popullsisë për këto bashki.
3. Rregullimi i Ekualizimit Fiskal për Bashkitë dhe Komunat			
Ekualizimi Fiskal (B/KPCR-NPCR)*(+/- 25%)*Popullsia [PCR] -TAPF = Të ardhura për frymë N = nacionale	25%	1,377,496	Ekualizimi fiskal bazohet në të ardhurat faktike nga tatimi vendor mbi biznesin e vogël, tatimi i thjeshtëzuar mbi të fitimin (të ardhurat faktike të biznesit të vogël vitit 2005 të korrigjuar me koeficientin (0.90), taksën e regjistrimit të automjeteve (faktike 2005). B/K që kanë të ardhura për frymë më të larta se sa të ardhurat nacionale për frymë kontribuojnë 25% të diferencës ndërmjet të dyjave shumëzuar me popullsinë e tyre. B/K që kanë të ardhura për frymë me të ulëta se të ardhurat nacionale për frymë marrin 25% të së njëjtës diferencë të llogaritur në të njëjtën mënyrë.
Rregullimi tranzitor (rezultati negativ kundrejt vitit 2006) (B/KR2006-B/KR2007)*(0.100) R = të ardhura për një vit të dhënë	Kufiri 0.00% koeficienti 100%	329,747	B/K të cilat, pas rezultateve të ekualizimit fiskal kane një grant që është me i ulët se në vitin 2006 kompensohen për diferencën në masën 100 %
Rregullimi tranzitor (rezultatet pozitive kundrejt vitit 2006)	Kufiri >15% Koeficient i 1.15%	(518,194)	Pas rezultateve të ekualizimit fiskal, ato B/K të cilat përfitojnë një rritje mbi 15% krahasuar me vitin 2006, kontribuojnë për rritjen e garancisë minimale për frymë në masën e tejkalimit mbi 15% krahasuar me rezultatin e transfertës për vitin 2006.
Kompensimi i garancisë minimale për frymë.	B – 3,200 minimumi për frymë K – 2,100 minimum për frymë	166,936	Për të siguruar një të ardhur të garantuar minimale për frymë, ky kompensim krahason të ardhurat përfundimtare për frymë (grantit të përshtatur për tranzicion, plus të ardhurat fiskale të listuar më përpara) me garancinë minimale prej (2100 lek/për frymë për komunat, 3200 lek/për frymë për bashkitë). Bashkitë ose Komunat marrin diferencën ndërmjet të dyjave, shumëzuar me popullsinë e tyre.
Fondi Neto i Kompensimit për bashkitë dhe komunat [FNK-B/K]		21,510	Ky fond është produkt i elementeve të mëposhtme: - Kompensimi tranzitor për rezultat negativ + Kompensimi tranzitor për rezultat pozitiv - Kompensimi i garancisë minimale për frymë Përdorimi i fondit kompensues për B/K bëhet sipas kriterëve të parashikuara, siç përshkruhet në Aneksin 3.

Kriteri	Koeficient i	Vlera (në mijë lekë)	Arsyeja themelore
4. Shuma Finale e Grantit të Përgjithshëm A për Bashkitë dhe Komunat			
Shuma në total e shpërndarjes së grantit për bashkitë dhe komunat		8,168,490	
5. Shpërndarja e Pjesës së Grantit A për Qarqet			
Granti i Përgjithshëm për Qarqet	98%	793,800	Për financimin e funksioneve bazë të qarqeve.
Fondi i Kompensimit për Qarqet	2%	16,200	Për financimin e rasteve të veçanta të shpenzimeve të qarqeve
6. Shpërndarja e Grantit të Përgjithshëm A për Qarqet			
Shuma fikse [SF-Q] = [Q] * 0.10	10%	79,380	Shuma fikse alokon një shumë të barabartë për çdo qark. Shuma në total [SF-Q] ndahet barabar mes qarqeve (pjesëtohet me numrin e qarqeve 12)
Popullsia [P-Q] = [Q] * 0.28	28%	222,264	Tipet e shërbimeve të siguruara nga qarku kanë një korrelacion negativ me popullsinë. Dhënia e një peshe më të madhe këtij kriteri do të penalizonte padrejtësisht më tepër qarqet më të varfra dhe me më pak banorë. Alokimi i [P-Q] bëhet proporcionalisht me popullsinë relative të çdo qarku kundrejt totalit të popullsisë.
Treguesi gjeografik [KG-Q] = [Q] * 0.30	30%	238,140	Ky është një tregues i rëndësishëm që merr parasysh avantazhet dhe dizavantazhet natyrore të vendndodhjes së qarkut. Për të karakterizuar tre zonat tipike të vendit: fushore – kodrinore – malore u përdor një shkallë përkatëse 1-3-5. Sa më e lartë shkalla aq më të mëdha fondet që do të alokohen për këtë koeficient. Alokimi i [KG-Q] bëhet proporcionalisht me raportin e shkallës së qarkut kundrejt shumës së shkallëve për të gjithë qarqet (32).
Koeficienti i Rugës [R-k] = [Q] * 0.32	32%	224,016	Alokimi [KR] ndahet proporcionalisht me gjatësinë relative të rrugëve për secilin qark, kundrejt gjatësisë totale.
7. Fonde të disponueshme për kompensim			
a. Kompensim për B/K b. Kompensimi për Q TOTALI		21,510 16,200 37,710	Përdorimi i këtyre fondeve të kompensimit do të bazohet në kriteret e caktuara paraprakisht dhe nga marrëveshja reciproke ndërmjet Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë së Financave.
B. Alokimi i pjesës B të Transfertës së Pakushtëzuar për Bashkitë dhe Komunat (Shuma B =1.725 miliard) – [TPB]			
Koeficienti i popullsisë	100%	1,725,000	Kriteri i vetëm i shpërndarjes është pesha relative e popullsisë bazuar në parimin fonde të barabarta për frymë. Pas aplikimit të këtij kriteri rezultati korrigjohet me katër koeficientet e mëposhtëm.
Koeficienti i drejtësisë (K-D)	0.3		Ky koeficient përdoret për të korrigjuar efektin e diferencave të shpërndarjes së

Kriteri	Koeficient i	Vlera (në mijë lekë)	Arsyeja themelore
			investimeve për rrugët rurale dhe urbane gjatë viteve 2002-2006. Aplikimi i koeficientit merr në konsideratë në mënyrë proporcionale fondet e përfituara nga çdo B/K në vitet 2002-2006 për fryme krahasuar me mesataren kombëtare për fryme. Bashkitë/komunat mbi këtë mesatare marrin në vitin 2007 fonde = $(1-0.3)$ shumëzuar me mesataren kombëtare për frymë 2007 dhe popullsinë përkatëse. Bashkitë/komunat nën mesataren kombëtare për frymë 2002-2006 marrin si më sipër por me koeficientin $(1+0.3)$.
Kriteri njëjësive malore (K-M)	3		Ky koeficient favorizon bashkitë/komunat malore nëpërmjet shumëzimit të popullsisë përkatëse të bashkisë me koeficientin 3.
Kriteri i bashkive në nevoje dhe malore	1.5		Ky koeficient favorizon bashkitë ne nevoje, nëpërmjet shumëzimit të popullsisë përkatëse të bashkisë me koeficientin 1.5.
Kriteri i bashkive malore	1.5		Ky koeficient favorizon bashkitë malore, nëpërmjet shumëzimit të popullsisë përkatëse të bashkisë me koeficientin 1.5.

ANEKS 2 KRITERET E SHPËRNDARJES SE FONDIT TË KOMPENSIMIT

Nivelet e Pushtetit Vendor	Kriteret
A. Fonde vetëm për bashkitë dhe komunat	- Kompensimi për ripershtatjen e kapacitetit fiskal, -Kompensimi bazuar ne kriterin e varfërisë (SKZHI),
B. Fonde vetëm për qarqet	-Disa shpenzime operative qe mund te nevojiten gjate vitit.

Ministria e Brendshme dhe Ministria e Financave shpallin dhe njoftojnë çdo bashki, komune dhe qark për sasinë e fondeve dhe arsyet e shpërndarjes se këtyre fondeve.

Procedurat për alokimin e këtij fondi përcaktohen ne udhëzimin e zbatimit te buxhetit te vitit 2007.

ANEKS 3 FONDET PËR GRANTET KONKURUESE DHE SHPËRNDARJA E TYRE

Fondet e buxhetit te shtetit të akorduara për Ministrinë e linjës dhe që financojnë projekte që sipas ligjit nr.8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” janë funksione të pushtetit vendor do të ndahen, monitorohen dhe kontrollohen në bashkëpunim me përfaqësuesit e pushtetit vendor. Ministrinë i akordojnë këto fonde për njesite perkatese vendore, bazuar në një sistem konkurrues, të hapur e transparent sipas kriterëve të përcaktuara në këtë aneks.

Keto fonde jane parashikuar ne zerin “grante konkurruese” dhe përbëhen nga fonde te buxhetit të shtetit, akorduar ministrive ose institucioneve, te destinuar për tu përdorur për shpenzime kapitale, te lidhura me funksionet e njësive te qeverisjes vendore.

Kriteret dhe procedurat e shpërndarjes së fondeve për grantet konkurruese mes njësive të qeverisjes vendore nga institucionet qendrore të përcaktuara në këtë aneks janë:

Shkalla e ndikimit të pritshëm në zhvillimin ekonomik e social si dhe shkalla e përputhshmërisë me përparësitë vendore dhe/ose rajonale të zhvillimit dhe kombëtare.

Shkalla e ndikimit në reduktimin e varfërisë dhe e rritjes së aksesit në shërbimet bazë.

Numri i përfituesve ne mënyre direkt dhe indirekte nga projekti.

Shkalla e nxitjes së bashkëpunimit mes njësive të qeverisjes vendore.

Niveli i pjesëmarrjes të komunitetit në vendimmarrje dhe me kontribute per projekte te infrastruktures rugore dhe ujesjellsa. Kontributi për komunat te varfra dhe malore deri ne 10 % e vlerës se plote te projektit, komunat e tjera deri ne 15%, bashkitë malore dhe ne nevojë deri ne 20 % te vlerës se plote te projektit dhe bashkitë e tjera deri ne 30% te vlerës se plote te projektit.

Fondi lidhet me koston lokale të një financimi të huaj.

Projekte në vazhdim, për të cilat ka detyrime kontraktore.

Cilësitë teknike të projekteve të propozuara nga njësitë e qeverisjes vendore

Shpërndarja e granteve konkurruese behet nga Komitetet perkatese te perbera nga perfaqesues te: Ministrise se Financave, Ministrive perkatese te Linjes, Ministrise se Brendshme dhe perfaqesues te shoqatave te njesive vendore. Ky komitet asistohet nga Fondi i Zhvillimit Shqiptar per vleresimin dhe listimin paraprak te projekteve. Celja e fondeve behet nga Ministria e Financave ne baze te vendimit te komitetit perkates ne te cilin specifikohet: emri i projektit, vlera e plote e projektit dhe fondi i aprovuar per vitin 2007.

Kodmin	Buxheti i vitit 2007 sipas Ministrive dhe Institucioneve	Fonde te pakushtezuara	Fonde te kushtezuara	Totali
1	Presidenca	130,000	0	130,000
2	Kuvendi	1,066,000	0	1,066,000
3	Keshilli Ministrave	612,000	0	612,000
4	Ministria e Ekonomise, Tregtise dhe Energjitikes	1,161,000	1,545,150	2,706,150
5	Ministria e Bujqesise, Ushqimit dhe Mbrojtjes se Konsumatorit.	3,534,970	1,981,000	5,515,970
6	Ministria e Puneve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit	22,291,450	18,069,550	40,361,000
9	Regjistrimi i Pasurive te Paluajtshme	336,000	376,800	712,800
10	Ministria e Financave	769,000	0	769,000
11	Ministria e Arsimit dhe Shkences	27,336,500	4,605,500	31,942,000
12	Ministria e Turizmit, Kultures, Rinise dhe Sporteve	2,334,000	317,000	2,651,000
13	Ministria e Shendetesise	20,057,123	2,391,877	22,449,000
14	Ministria e Drejtise	3,388,780	1,496,200	4,884,980
15	Ministria e Puneve te Jashtme	1,948,300	20,700	1,969,000
16	Ministria e Brendshme	11,443,533	1,712,235	13,155,768
17	Ministria e Mbrojtjes	17,387,500	731,500	18,119,000
18	Sherbimi Informativ Shteteror	1,002,365	12,635	1,015,000

19	Drejtoria e Radio Televizionit	312,000	0	312,000
20	Drejtoria e Pergjithshme e Arkivave	177,000	0	177,000
21	Drejtoria e Rezervave te Shtetit	100,000	5,000	105,000
22	Akademia e Shkences	488,750	18,500	507,250
24	Kontrolli Larte i Shtetit	242,000	0	242,000
25	Ministria e Punes, Ceshtjeve Sociale dhe Shanseve te Barabarta	35,095,100	445,000	35,540,100
26	Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit te Ujrave	1,061,400	789,600	1,851,000
28	Prokuroria e Pergjithshme	961,000	0	961,000
29	Zyra e Administrimit te Buxhetit Gjyqesor	1,255,700	300	1,256,000
30	Gjykata Kushtetuese	91,000	0	91,000
31	Agjensia Telegrafike Shqiptare	80,000	5,000	85,000
35	Drejtoria e Pergjithshme e Doganave	1,205,000	0	1,205,000
37	Drejtoria e Pergjithshme e Standartizimit	26,000	0	26,000
40	Partite Politike	200,000	0	200,000
41	Drejtoria e Pergjithshme e Tatimeve	1,598,000	0	1,598,000
48	Drejtoria e Metrologjise dhe Kalibrimit	24,000	0	24,000
50	Instituti Statistikes	152,000	9,000	161,000
53	Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare	32,000	0	32,000
55	Shkolla e Magjistratures	53,000	0	53,000
56	Fondi i Zhvillimit Shqiptar	650,000	1,561,000	2,211,000
57	Qendra Kombetare e Kinematografise	85,600	1,400	87,000
59	Instituti i Integritetit te Perndjekurve Politik	23,000	0	23,000
63	Keshilli i Larte i Drejtesise	65,000	0	65,000
66	Avokati i Popullit	113,000	0	113,000
67	Komisioni i Sherbimit Civil	43,000	0	43,000
73	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve	348,000	0	348,000
75	Avokati i Shtetit	56,000	0	56,000
76	Inspektoriati i Larte Kontrollit te Deklarimit te Pasurive	82,000	0	82,000
77	Autoriteti i Konkurences	51,000	0	51,000
78	Ministria e Integritetit	111,000	4,000	115,000
79	Agjensia e Kthimit dhe Kompensimit te Pronave	675,000	0	675,000
82	Keshilli Kombetar Kontabilitetit	12,000	0	12,000
83	Drejtoria e Pergjithshme e Parandalimit te Pastrimit te Parave	42,000	0	42,000
	Totali	160,309,071	36,098,947	196,408,018

kontroll	160309071	36098947	196,408,018
	0	0	0

Kodmin	Institucionet e Pavarura	Nr. Punonjesve	Paga 600+601	Buxheti Total
1	Presidenca	66	64,000	130,000
2	Kuvendi	434	479,000	1,066,000
24	Kontrolli Larte i Shtetit	160	176,000	242,000
28	Prokuroria e Pergjithshme	822	793,000	961,000
29	Zyra e Administrimit Buxhetit Gjyqesor	1,230	986,000	1,256,000
30	Gjykata Kushtetuese	50	65,000	91,000
53	Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare	37	0	32,000
55	Shkolla e Magjistratures	22	20,000	53,000
63	Keshilli i Larte i Drejtesise	41	44,000	65,000
66	Avokati i Popullit	45	55,000	113,000
67	Komisioni i Sherbimit Civil	28	30,000	43,000
73	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve	60	71,000	348,000
76	Inspektoriati i Larte Kontrollit te Deklarimit te Pasurive	41	55,000	82,000
77	Autoriteti i Konkurences	35	35,000	51,000

Kodi	Investimet e vitit 2007 sipas Ministrive dhe Institucioneve	Nga Buxheti	Nga te Ardhurat	Financimi i Huaj	Totali
1	Presidenca	4,000	0	0	4,000
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	4,000	0	0	4,000
2	Kuvendi	280,000	0	0	280,000
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	280,000	0	0	280,000
3	Keshilli Ministrave	189,000	0	0	189,000
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	14,000	0	0	14,000
01320	Sherbime Qeveritare	175,000	0	0	175,000
01130	Sherbimi i Prokurimit Publik	0	0	0	0
01150	Sherbime te tjera	0	0	0	0
4	Ministria e Ekonomise, Tregtise dhe Energjitikes	405,000	0	1,545,150	1,950,150
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	26,000	0	0	26,000
04320	Mbeshtetje per Energjine	20,000	0	0	20,000
04430	Mbeshtetje Gjeoshkenca e te tjera	222,300	0	0	222,300
04440	Mbesht. Miniera e Nd/je Publike	69,000	0	0	69,000
04130	Mbeshtetje per Zhvillim Ekonomik	55,000	0	1,545,150	1,600,150
04160	Sherbimet e Tregut, Akreditim dhe Inspektim	12,700	0	0	12,700
5	Ministria e Bujqesise, Ushqimit dhe Mbrojtjes se Konsumatorit	1,315,000	0	1,949,700	3,264,700
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	2,000	0	0	2,000
04220	Siguria ushqimore dhe mbrojtja e konsumatorit	55,800	0	252,000	307,800
04240	Menaxhimi i infrastruktures se kullimit dhe ujitjes	809,700	0	1,101,900	1,911,600
04250	Mbesh.e prodh. Bujq, blek, agroind, dhe market.	291,000	0	273,000	564,000
04860	Keshillimi dhe Informacioni Bujqesor	120,500	0	0	120,500
05470	Menaxhimi qendrueshem i tokes bujqesore	0	0	0	0
04280	Zhvillimi i Integruar Rural	36,000	0	322,800	358,800
6	Ministria e Puneve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit	18,534,000	0	18,063,000	36,597,000
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	20,000	0	0	20,000
04520	Rrjeti i rrugeve nacionale	13,926,708	0	13,928,586	27,855,294
04530	Menaxhimi i Transportit	15,000	0	0	15,000
04540	Portet	220,000	0	350,000	570,000
04550	Hekurudhat	290,000	0	0	290,000
04560	Aviacioni Civil	45,000	0	0	45,000

06370	Ujesjelles Kanalizime	3,122,292	0	3,476,504	6,598,796
06180	Strehimi dhe Urbanistika	870,000	0	307,910	1,177,910
06220	Sherbimet publike	25,000	0	0	25,000
9	Regjistrimi i Pasurive te Paluajtshme	30,000	0	302,800	332,800
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	30,000	0	302,800	332,800
10	Ministria e Financave	35,000	0	0	35,000
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	35,000	0	0	35,000
01120	Parashikimet Makroekonomike dhe Fiskale	0	0	0	0
01130	Ekzekutimi i Pagesave te ndryshme	0	0	0	0
04140	Mbeshtetje dhe Pjesemarrje ne Institucionet Financiare	0	0	0	0
01150	Planifikimi i Buxhetit te Shtetit	0	0	0	0
01160	Ekzekutimi i Buxhetit te Shtetit	0	0	0	0
01170	Menaxhimi i Borxhit te Shtetit	0	0	0	0
01180	Auditimi i Brendshem dhe Kontrolli i Financave Publike	0	0	0	0
11	Ministria e Arsimit dhe Shkences	4,005,000	845,000	2,377,000	7,227,000
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	4,000	5,000	6,000	15,000
09120	Arsimi Baze (perfshire parashkollorin)	2,180,000	0	1,142,000	3,322,000
09230	Arsimi i Mesem (i pergjithshem)	730,100	5,000	675,000	1,410,100
09240	Arsimi i Mesem (profesional)	302,200	4,000	154,000	460,200
09450	Arsimi Universitar	638,700	831,000	400,000	1,869,700
09770	Fonde per Shkencen	150,000	0	0	150,000
12	Ministria e Turizmit, Kultures, Rinise dhe Sporteve	1,070,000	0	317,000	1,387,000
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	6,000	0	0	6,000
08220	Trashegimia Kulturore, Muzete dhe Kultet	133,510	0	0	133,510
08230	Arti dhe Kultura	849,150	0	317,000	1,166,150
08140	Zhvillimi i Sportit	56,340	0	0	56,340
08250	Projekte Turistike, Kulturore dhe Sportive	0	0	0	0
04760	Zhvillimi i Turizmit	25,000	0	0	25,000
13	Ministria e Shendetesise	2,868,000	37,000	2,050,000	4,955,000
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	44,500	3,000	0	47,500
07220	Sherbimet e Kujdesit Paresor	959,806	15,000	900,000	1,874,806
07330	Sherbimet e Kujdesit Dytesor	1,818,694	15,000	1,150,000	2,983,694
07450	Sherbimet e Shendetit Publik	45,000	4,000	0	49,000
14	Ministria e Drejtesise	635,500	1,500	1,485,600	2,122,600

01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	87,220	0	692,000	779,220
01120	Publikimet Zyrtare	7,000	500	86,800	94,300
01130	Mjekesia Ligjore	25,000	0	0	25,000
03440	Sistemi i Burgjeve	506,180	0	706,800	1,212,980
03350	Sherbimi i Permbarimit Gjyqesor	10,100	0	0	10,100
01160	Sherbimet per çeshtjet e biresimeve	0	1,000	0	1,000
15	Ministria e Puneve te Jashtme	440,000	0	0	440,000
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	406,000	0	0	406,000
01120	Perfaqesite Diplomatike	34,000	0	0	34,000
16	Ministria e Brendshme	365,000	35,000	1,206,768	1,606,768
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	86,000	0	0	86,000
09420	Arsimi dhe Shkenca (Akademia)	6,000	0	0	6,000
03140	Policia e Shtetit	218,000	35,000	1,206,768	1,459,768
03150	Garda e Republikes	15,000	0	0	15,000
01160	Prefekturat dhe FunkSIONET e Deleguara te P. Vendor	10,000	0	0	10,000
01170	Sherbimi i Gjendjes Civile	10,000	0	0	10,000
03280	Sherbimi i Mbrojtjes nga Zjarri	20,000	0	0	20,000
10910	Emergjencat	0	0	0	0
17	Ministria e Mbrojtjes	4,342,000	100,000	620,000	5,062,000
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	295,300	0	0	295,300
02120	Forcat e Luftimit	1,899,673	0	0	1,899,673
09430	Arsimi Ushtarak	306,086	0	0	306,086
07340	Mbeshtetje Shendetesore	99,440	0	620,000	719,440
02150	Mbeshtetja e Luftimit	1,398,701	100,000	0	1,498,701
02160	Mbeshtetja e Pergendruar	321,100	0	0	321,100
10270	Mbeshtetje Sociale per Ushtaraket	0	0	0	0
02280	Bashkepuni Civilo - Ushtarak (AL-CIMIC)	21,700	0	0	21,700
18	Sherbimi Informativ Shteteror	25,000	0	0	25,000
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	20,403	0	0	20,403
09420	Arsimi	4,597	0	0	4,597
19	Drejtoria e Radio Televizionit	0	0	0	0
08310	Sherbimet per shqiptaret jashte kufirit dhe sherbimi per te huajt ne gjuhe huaj + Sateliti	0	0	0	0
08520	Projekte teknike per futjen e teknologjive te reja	0	0	0	0
08330	Prodhime filmike ose veprimtari artistike	0	0	0	0

	mbarekombetare				
08340	Orkestra Simfonike e RTSH dhe Kinematografise	0	0	0	0
20	Drejtoria e Pergjithshme e Arkivave	70,000	0	0	70,000
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	70,000	0	0	70,000
21	Drejtoria e Rezervave te Shtetit	0	5,000	0	5,000
01320	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	0	5,000	0	5,000
22	Akademia e Shkences	17,000	0	0	17,000
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	17,000	0	0	17,000
24	Kontrolli Larte i Shtetit	30,000	0	0	30,000
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	30,000	0	0	30,000
25	Ministria e Punes, Ceshtjeve Sociale dhe Shanseve te Barabarta	199,000	1,000	436,000	636,000
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	50,000	0	0	50,000
10220	Sigurimi Shoqeror	0	0	0	0
10430	Mbrojtja Sociale	68,000	0	360,000	428,000
10550	Tregu i Punes	81,000	1,000	76,000	158,000
04170	Inspektimi ne Pune	0	0	0	0
10460	Shanset e Barabarta	0	0	0	0
26	Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit te Ujrave	203,400	217,600	500,000	921,000
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	8,000	0	0	8,000
05320	Programe per mbrojtjen e Mjedisit	55,400	0	205,000	260,400
04230	Mbeshtetje per Peshkimin	28,000	0	120,000	148,000
05640	Administrimi i Ujrave	0	0	0	0
04260	Administrimi i Pyjeve	112,000	217,600	175,000	504,600
28	Prokuroria e Pergjithshme	30,000	0	0	30,000
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	30,000	0	0	30,000
29	Zyra e Administrimit Buxhetit Gjygsor	70,000	0	0	70,000
03310	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	70,000	0	0	70,000
30	Gjykata Kushtetuese	5,000	0	0	5,000
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	5,000	0	0	5,000
31	Agjensia Telegrafike Shqiptare	5,000	0	0	5,000
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	5,000	0	0	5,000
35	Drejtoria e Pergjithshme e Doganave	70,000	0	0	70,000
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	70,000	0	0	70,000
37	Drejtoria e Pergjithshme e Standartizimit	2,000	0	0	2,000

04110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	2,000	0	0	2,000
40	Partite Politike	0	0	0	0
41	Drejtoria e Pergjithshme e Tatimeve	100,000	0	0	100,000
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	100,000	0	0	100,000
48	Drejtoria e Metrologjise dhe Kalibrimit	5,000	0	0	5,000
04110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	5,000	0	0	5,000
50	Instituti Statistikes	6,000	0	0	6,000
01310	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	6,000	0	0	6,000
53	Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare	2,000	0	0	2,000
04110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	2,000	0	0	2,000
55	Shkolla e Magjistratures	3,000	0	0	3,000
03310	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	3,000	0	0	3,000
56	Fondi i Zhvillimit Shqiptar	650,000	0	1,561,000	2,211,000
06210	Programe Zhvillimi	650,000	0	1,561,000	2,211,000
57	Qendra Kombetare e Kinematografise	2,000	0	0	2,000
08210	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	2,000	0	0	2,000
59	Instituti i Integritetit te Perndjekurve Politik	2,000	0	0	2,000
01110	Rehabilitimi i te Perndjekurve Politik	2,000	0	0	2,000
63	Keshilli i Larte i Drejtesise	5,000	0	0	5,000
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	5,000	0	0	5,000
66	Avokati i Popullit	40,000	0	0	40,000
03310	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	40,000	0	0	40,000
67	Komisioni i Sherbimit Civil	2,000	0	0	2,000
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	2,000	0	0	2,000
73	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve	10,000	0	0	10,000
01610	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	10,000	0	0	10,000
01620	Zgjedhjet e pergjithshme dhe lokale	0	0	0	0
75	Avokati i Shtetit	3,000	0	0	3,000
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	3,000	0	0	3,000
76	Inspektoriati i Larte Kontrollit te Deklarimit te Pasurive	4,000	0	0	4,000
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	4,000	0	0	4,000
77	Autoriteti i Konkurences	5,000	0	0	5,000
04110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	5,000	0	0	5,000
78	Ministria e Integritetit	20,000	0	4,000	24,000

01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	18,800	0	1,200	20,000
01140	Drejtësia dhe Tregu i Brendshëm	600	0	1,600	2,200
01150	Mbeshtetja Institucionale për Procesin e Integritetit	600	0	1,200	1,800
79	Agjensia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave	5,000	0	0	5,000
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	5,000	0	0	5,000
82	Keshilli Kombëtar Kontabilitetit	2,000	0	0	2,000
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	2,000	0	0	2,000
83	Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave	2,000	0	0	2,000
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	2,000	0	0	2,000
	Totali	36,111,900	1,242,100	32,418,018	69,772,018

Nga e cila: Kontigjence		Nga Buxheti	Nga të ardhurat	Financimi i Huaj	Totali
5	Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit	100,000	0	0	100,000
6	Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit	2,000,000	0	0	2,000,000
11	Ministria e Arsimit dhe Shkencës	300,000	0	0	300,000
12	Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve	150,000	0	0	150,000
13	Ministria e Shëndetësisë	300,000	0	0	300,000
14	Ministria e Drejtësisë	50,000	0	0	50,000
15	Ministria e Punëve të Jashtme	100,000	0	0	100,000
s	Totali	3,000,000	0	0	3,000,000

kontroll	36,111,900	1,242,100	32,418,018	69,772,018
	0	0	0	0

ne 000
Lek

Nr	Emertimi	Korente	Investime	Totali
1	Gjykata e Larte	171,000	2,300	173,300
2	Gjykatat e Apelit	226,000	5,000	231,000
3	Gjykatat e Faktit	769,000	62,100	831,100
4	Z.A.B.GJ.	20,000	600	20,600
	Shuma	1,186,000	70,000	1,256,000

Kontroll
1,186,000 70,000 1,256,000

0 0 0

Tabela nr. 4

TRANSFERTA E PAKUSHTEZUAR (A+B) PER BASHKITE DHE KOMUNAT 2007

Ne mije leke

Nr	Qarku	Rrethi	Njesite e Qeverisjes Vendore	Bashki (B) Komune (K)	Transferta e Pakushtezuar (A)	Transferta e Pakushtezuar per Investime (B)	Gjithsej Transferta e Pakushtezuar (A+B)
1	Berat	Berat	Berat	B	134,617	10,000	144,617
2	Berat	Berat	Cukalat	K	9,433	4,293	13,726
3	Berat	Berat	Kutalli	K	25,413	4,373	29,787
4	Berat	Berat	Lumas	K	14,390	2,038	16,428
5	Berat	Berat	Otilak	K	25,314	3,847	29,161
6	Berat	Berat	Poshnjë	K	17,504	3,679	21,182
7	Berat	Berat	Roshnik	K	14,533	4,085	18,618
8	Berat	Berat	Sinjë	K	16,515	5,155	21,670
9	Berat	Berat	Tërpan	K	12,609	3,711	16,320
10	Berat	Berat	Ura-Vajgurore	B	25,624	2,217	27,842
11	Berat	Berat	Velabisht	K	23,912	3,963	27,875
12	Berat	Berat	Vertop	K	19,495	7,142	26,637
13	Berat	Kuçovë	Kozarë	K	14,984	1,512	16,496
14	Berat	Kuçovë	Kuçovë	B	54,353	4,000	58,353
15	Berat	Kuçovë	Perondi	K	24,456	2,270	26,726
16	Berat	Skrapar	Bogovë	K	10,245	4,000	14,245
17	Berat	Skrapar	Cepan	K	9,877	2,291	12,168
18	Berat	Skrapar	Çorovodë	B	31,689	8,116	39,805
19	Berat	Skrapar	Gjerbes	K	10,054	1,000	11,054
20	Berat	Skrapar	Leshnjë	K	6,767	654	7,421
21	Berat	Skrapar	Poliçan	B	30,164	8,545	38,710
22	Berat	Skrapar	Potom	K	8,582	989	9,571
23	Berat	Skrapar	Qendër	K	17,001	6,398	23,399
24	Berat	Skrapar	Vendreshe	K	7,708	2,105	9,813
25	Berat	Skrapar	Zhepë	K	11,074	2,367	13,441
26	Dibër	Bulqizë	Bulqizë	B	45,217	15,000	60,217
27	Dibër	Bulqizë	Fushë-Bulqizë	K	11,283	3,385	14,668

28	Dibër	Bulqizë	Gjoricë	K	12,426	7,000	19,426
29	Dibër	Bulqizë	Martanesh	K	14,684	3,917	18,601
30	Dibër	Bulqizë	Ostren	K	14,266	4,778	19,044
31	Dibër	Bulqizë	Shupenzë	K	18,832	8,051	26,884
32	Dibër	Bulqizë	Trebisht	K	6,597	1,163	7,760
33	Dibër	Bulqizë	Zerqan	K	19,074	8,000	27,074
34	Dibër	Dibër	Arras	K	12,888	5,620	18,508
35	Dibër	Dibër	Fushë Muhurr	K	10,316	4,364	14,679
36	Dibër	Dibër	Fushë-Çidhen	K	9,990	2,500	12,490
37	Dibër	Dibër	Kala e Dodës	K	11,871	5,000	16,871
38	Dibër	Dibër	Kastriot	K	20,141	2,868	23,009
39	Dibër	Dibër	Lurë	K	10,279	1,635	11,914
40	Dibër	Dibër	Luzni	K	9,453	3,679	13,132
